KOLEGJI • COLLEGE
TEMPULLI

PLAN STRATEGJIK

2026-2030

KOLEGJI TEMPULLI

Prishtinë, Dhjetor 2025

Fjala e Drejtorit

Kolegji Tempulli është institucion i arsimit të lartë me profil profesional dhe akademik, i cili ndërthur mësimdhënien, kërkimin e aplikuar dhe zhvillimin e kompetencave praktike, duke përgatitur profesionistë të aftë për t'iu përgjigjur nevojave të tregut të punës dhe zhvillimit të shoqërisë.

Që nga themelimi i tij, Kolegji është zhvilluar vazhdimisht përmes avancimit të programeve studimore, ngritjes së kapaciteteve të stafit, investimeve në laboratorë dhe infrastrukturë, si dhe forcimit të sistemit të sigurimit të cilësisë. Bashkëpunimi me institucionet publike, industrinë, bizneset, organizatat profesionale dhe partnerët vendorë e ndërkombëtarë ka qenë pjesë e rëndësishme e këtij zhvillimi. Përmes partneriteteve strategjike, projekteve, programeve Erasmus+, rrjeteve akademike dhe profesionale, Kolegji ka krijuar mundësi të reja për studentët, stafin dhe komunitetin.

Plani Strategjik 2026–2030 mbështetet në rezultatet dhe përvojën e Planit Strategjik 2021–2025. Ai nuk paraqet shkëputje nga strategjia e mëparshme, por vazhdimësi dhe avancim të saj, duke reflektuar fazën e re të zhvillimit të Kolegjit Tempulli. Fokusi i tij është cilësia akademike, mësimdhënia e orientuar në praktikë, kërkimi shkencor dhe i aplikuar, inovacioni, transformimi digjital, ndërkombëtarizimi, zhvillimi i qëndrueshëm dhe angazhimi në shoqëri.

Ky plan do të shërbejë si udhërrëfyes për vendimmarrjen dhe zhvillimin institucional gjatë pesë viteve të ardhshme. Zbatimi i tij kërkon përkushtimin e menaxhmentit, stafit, studentëve dhe të gjithë partnerëve.

Menaxhmenti i Kolegjit Tempulli shpreh mirënjohjen për stafin akademik dhe administrativ, studentët, alumnit, partnerët dhe të gjithë bashkëpunëtorët që kanë kontribuar në zhvillimin e institucionit dhe në hartimin e këtij Plani Strategjik.

Menaxhmenti mbetet i përkushtuar që, përmes bashkëpunimit, cilësisë dhe përmirësimit të vazhdueshëm, ta fuqizojmë më tej Kolegjin Tempulli si institucion modern, inovativ dhe të përgjegjshëm ndaj studentëve dhe shoqërisë.

Prof. Dr. Muhamed Krasniqi
Drejtor

HYRJE

PROCESI I HARTIMIT TË PLANIT STRATEGJIK

Plani Strategjik për zhvillimin e Kolegjit Kolegjit Tempulli për vitet 2026-2030 është hartuar nëpërmjet një procesi me pjesëmarrje të gjerë të personelit, partnerëve strategjik dhe të ekspertizës në dispozicion në Kosovë. Procesin e hartimit e ka udhëhequr Menaxhmenti i lartë i Kolegjit Tempulli që për këtë qëllim ka krijuar grupin punues me përfaqësim nga Këshilli Drejtues, menaxhmenti, personeli (akademik dhe administrativ) dhe përfaqësues nga akterët e jashtëm (bizneset) dhe përfaqësues nga Parlamenti Studentor.

Grupi punues ka mbajtur katër mbledhje koordinuese me përfaqësues të ekipeve dhe me ekspertët e angazhuar në të cilat janë kryer veprimet në vijim:

- Punëtoria 1: Analiza e gjendjes dhe vlerësimi institucional përmes analizës SWOT
- Punëtoria 2: Përcaktimi i objektivave dhe prioriteteve strategjike, treguesëve kryesorë të përformancës dhe caqeve
- Punëtoria 3: Hartimi i Planit të Veprimit, kostimi i aktiviteteve dhe zhvillimi i kornizës për menaxhimin e rreziqeve, monitorimin, vlerësimin dhe komunikimin e Planit Strategjik.
- Punëtoria 4: Shqyrtimi, harmonizimi dhe finalizimi i draftit të Planit Strategjik 2026–2030

Në fund, plani i finalizuar u është dërguar në shqyrtim të fundit anëtarëve të grupeve punuese, është miratuar nga Këshilli Drejtues dhe është dërguar për përkthim.

Plani Strategjik 2026 – 2030 paraqet vizionin zhvillimor të Kolegjit Tempulli në pesë vitet e ardhshme. Plani është plotësisht në përputhje me Kornizën Ligjore dhe me kornizën e akreditimit në fuqi në Kosovë. Në periudhën e ardhshme zhvillimore përfshihen zhvillime fondamentale që do ta përcaktojnë dhe konsolidojnë pozicionin e Kolegjit Tempulli në skenën e arsimit të lartë profesional në Kosovë. Gjatë kësaj periudhe parashihet kalimi në objektin e ri, forcimi i bashkëpunimit me partnerët dhe institucionet vendore e ndërkombëtare, avancimi i administratës dhe i shërbimeve të digjitalizuara, investimi në laboratore, zgjerimi me programe të reja, avancimi i cilësisë dhe i përfshirjes së studentëve në një numër shumë më të madh të shërbimeve arsimore në shkencat e aplikuara, arsimin e lartë profesional, shërbime komunitare, ekspertiza në trafik, kurse të shkurta aftësuese dhe në programe atraktive studimore.

PROFILI INSTITUCIONAL DHE ANALIZA E GJENDJES AKTUALE

Kolegji Tempulli është institucion i arsimit të lartë me një traditë të gjatë në zhvillimin e arsimit profesional dhe akademik në Kosovë. Rrënjët e tij datojnë nga viti 1992, kur filloi veprimtarinë si qendër për aftësimin dhe edukimin e kandidatëve për drejtues të automjeteve. Duke iu përgjigjur vazhdimisht nevojave të tregut të punës dhe zhvillimeve shoqërore, institucioni ka evoluar ndër vite nga një qendër profesionale në një institucion të arsimit të lartë, duke zgjeruar ofertën e tij akademike dhe duke konsoliduar profilin si institucion që ndërthur mësimdhënien, kërkimin e aplikuar dhe zhvillimin e kompetencave profesionale.

Një moment i rëndësishëm në zhvillimin institucional të Tempullit ishte viti 2024, kur institucioni ndryshoi emërtimin zyrtar nga Akademia Tempulli në Kolegji Tempulli. Ky ndryshim nuk përfaqësonte një transformim të misionit apo të traditës së institucionit, por një harmonizim të identitetit të tij me profilin akademik dhe profesional që ka ndërtuar ndër vite. Emërtimi "Kolegji" pasqyron më saktë orientimin e Tempullit drejt arsimit të lartë teknik dhe profesional, programeve të specializuara dhe formimit të kuadrove me kompetenca të avancuara për tregun e punës. Duke ruajtur trashëgiminë dhe reputacionin e ndërtuar që nga themelimi, ky vendim strategjik forcoi identitetin institucional, rriti qartësinë e pozicionimit në sistemin e arsimit të lartë dhe mbështeti vizionin afatgjatë për zhvillimin e një institucioni modern, të orientuar drejt cilësisë, inovacionit dhe nevojave të ekonomisë bashkëkohore.

Gjatë viteve të fundit, Kolegji Tempulli ka investuar në zhvillimin e programeve studimore, ngritjen e kapaciteteve të stafit akademik, modernizimin e infrastrukturës dhe laboratorëve, avancimin e sistemit të sigurimit të cilësisë dhe forcimin e bashkëpunimit me institucionet publike, sektorin privat dhe partnerët vendorë e ndërkombëtarë. Këto zhvillime kanë kontribuar në rritjen e cilësisë së procesit mësimor, zgjerimin e aktiviteteve kërkimore dhe rritjen e ndikimit të Kolegjit në zhvillimin profesional dhe shoqëror.

Në një mjedis të karakterizuar nga ndryshime të vazhdueshme teknologjike, transformimi digjital, zhvillimet demografike dhe kërkesat gjithnjë në rritje të tregut të punës, Kolegji Tempulli e konsideron përshtatjen dhe inovacionin si elemente kyçe të zhvillimit të tij institucional. Për këtë arsye, programet studimore dhe aktivitetet akademike zhvillohen në bashkëpunim të ngushtë me punëdhënësit, industrinë, institucionet publike dhe organizatat profesionale, me qëllim që studentët të fitojnë njohuri dhe kompetenca që i përgjigjen nevojave reale të tregut të punës.

Një nga karakteristikat dalluese të Kolegjit Tempulli është orientimi i tij drejt bashkëpunimit me komunitetin dhe industrinë. Përmes partneriteteve strategjike me institucione publike, kompani, organizata profesionale dhe universitete vendore e ndërkombëtare, Kolegji realizon projekte të përbashkëta, kërkim të aplikuar, ekspertiza profesionale, praktika studentore dhe aktivitete të zhvillimit profesional. Pjesëmarrja në programet Erasmus+, rrjetet akademike ndërkombëtare dhe projektet kërkimore ka forcuar më tej dimensionin ndërkombëtar të institucionit dhe ka krijuar mundësi të reja për mobilitetin dhe zhvillimin akademik të studentëve dhe stafit.

Kolegji Tempulli vazhdon të japë një kontribut të rëndësishëm edhe në zhvillimin e komunitetit, veçanërisht në fushën e sigurisë rrugore. Përmes bashkëpunimit me institucionet shtetërore, organizatat profesionale dhe partnerët strategjikë, realizohen vazhdimisht aktivitete edukative, fushata ndërgjegjësuese, projekte profesionale dhe iniciativa me interes publik, të cilat synojnë rritjen e kulturës së sigurisë rrugore dhe përmirësimin e cilësisë së jetës në komunitet.

Në funksion të forcimit të lidhjes ndërmjet arsimit të lartë dhe zhvillimit ekonomik, Kolegji Tempulli ka zhvilluar struktura të veçanta për zhvillimin profesional dhe kërkimin e aplikuar. Qendra për Hulumtim dhe Zhvillim Profesional është e orientuar në organizimin e trajnimeve profesionale, edukimin e vazhdueshëm dhe zhvillimin e kompetencave në përputhje me nevojat e tregut të punës. Ndërkaq, Instituti për Siguri Rrugore dhe Hulumtime në Transport mbështet dhe zhvillon hulumtime shkencore dhe të aplikuara, ekspertiza profesionale dhe projekte në bashkëpunim me industrinë, institucionet publike, organizatat profesionale dhe komunitetin. Përmes këtyre dy strukturave, Kolegji kontribuon në zhvillimin profesional, transferimin e dijes, inovacionin dhe zhvillimin e qëndrueshëm ekonomik e shoqëror.


Përvoja e fituar gjatë zbatimit të Planit Strategjik 2021–2025, rezultatet e arritura, rekomandimet e proceseve të sigurimit të cilësisë dhe ndryshimet në mjedisin e arsimit të lartë kanë krijuar bazën për hartimin e Planit Strategjik 2026–2030. Ky plan paraqet vazhdimësinë e zhvillimit institucional të Kolegjit Tempulli dhe përcakton drejtimet strategjike për forcimin e qeverisjes institucionale, cilësisë akademike, kërkimit shkencor dhe të aplikuar, ndërkombëtarizimit, transformimit digjital, zhvillimit të qëndrueshëm dhe angazhimit në shoqëri.

Kolegji Tempulli synon të zhvillojë aktivitetin e tij në përputhje me parimet e zhvillimit të qëndrueshëm, duke integruar gradualisht politikat e gjelbra (Green Policy) dhe parimet ESG (Environmental, Social and Governance) në qeverisjen institucionale, proceset akademike, kërkimin shkencor, bashkëpunimin me komunitetin dhe menaxhimin e infrastrukturës. Ky angazhim synon të kontribuojë në mbrojtjen e mjedisit, përdorimin e përgjegjshëm të burimeve dhe zhvillimin e një kulture institucionale të qëndrueshme.

Struktura organizative e Kolegjit Tempulli

Struktura organizative e Kolegjit Tempulli përcaktohet me Statutin e Kolegjit dhe është ndërtuar në përputhje me Ligjin për Arsimin e Lartë në Republikën e Kosovës, aktet e tjera relevante ligjore dhe standardet e sigurimit të cilësisë në arsimin e lartë.

Ajo përcakton organet drejtuese dhe vendimmarrëse, njësitë akademike, administrative, profesionale dhe kërkimore, si dhe përgjegjësitë dhe raportet funksionale ndërmjet tyre. Struktura synon të sigurojë qeverisje efektive, ndarje të qartë të përgjegjësive, koordinim institucional dhe mbështetje të qëndrueshme për realizimin e misionit dhe objektivave strategjike të Kolegjit Tempulli. Struktura organizative dhe raportet funksionale ndërmjet njësive të Kolegjit Tempulli paraqiten në organogramin në vijim.



Rezultatet e analizës SWOT

Analiza SWOT është hartuar për të vlerësuar gjendjen aktuale të Kolegjit Tempulli dhe faktorët e brendshëm e të jashtëm që ndikojnë në zhvillimin e tij institucional dhe akademik. Ajo identifikon përparësitë dhe dobësitë e brendshme të Kolegjit, si dhe mundësitë dhe rreziqet që burojnë nga mjedisi i jashtëm.

Gjetjet e kësaj analize janë mbështetur në përvojën institucionale, rezultatet e zbatimit të Planit Strategjik 2021–2025, proceset e sigurimit të cilësisë dhe akreditimit, konsultimet me palët e interesit, zhvillimet në arsimin e lartë, kërkesat e tregut të punës dhe orientimet e reja teknologjike e shoqërore. Rezultatet e analizës SWOT kanë shërbyer si bazë për përcaktimin e objektivave dhe prioriteteve strategjike të Planit Strategjik 2026–2030.

Përparësitë

- Tradita dhe përvoja institucionale e Kolegjit Tempulli, me profil të orientuar drejt shkencave të aplikuara dhe ndërlidhjes së arsimit akademik me mësimdhënien praktike dhe zhvillimin profesional.
- Programe dhe profile specifike të studimit, të orientuara drejt nevojave të tregut të punës dhe fushave relevante për zhvillimin ekonomik dhe shoqëror.
- Staf akademik dhe profesional me kualifikime dhe përvojë relevante akademike, profesionale dhe praktike.
- Infrastrukturë dhe laboratorë bashkëkohorë për realizimin e mësimdhënies praktike dhe aktiviteteve profesionale e kërkimore.
- Sistem i konsoliduar i sigurimit të cilësisë dhe mekanizma institucionalë për vlerësimin dhe përmirësimin e vazhdueshëm të proceseve akademike dhe institucionale.
- Kapacitete institucionale për zhvillimin e kërkimit shkencor dhe të aplikuar, ekspertizave profesionale dhe projekteve në bashkëpunim me industrinë, institucionet dhe komunitetin.
- Funksionimi i Institutit për Siguri Rrugore dhe Hulumtime në Transport dhe i Qendrës për Hulumtim dhe Zhvillim Profesional si struktura mbështetëse për kërkimin e aplikuar, zhvillimin profesional dhe transferimin e dijes.
- Partneritete dhe marrëveshje bashkëpunimi me sektorin akademik, publik, privat dhe profesional në nivel vendor dhe ndërkombëtar.
- Anëtarësimi dhe pjesëmarrja në organizata dhe rrjete ndërkombëtare në fushat relevante të veprimtarisë së Kolegjit.
- Ofrimi i shkathtësive dhe kompetencave profesionale në përputhje me kërkesat e tregut të punës dhe lidhja e ngushtë me industrinë dhe punëdhënësit.
- Kapacitete dhe përvojë në organizimin e aktiviteteve me interes publik, fushatave ndërgjegjësuese dhe iniciativave në fushën e sigurisë rrugore dhe angazhimit në komunitet.
- Përvojë në bashkëpunimin dhe realizimin e aktiviteteve dhe projekteve me institucione vendore dhe ndërkombëtare.Implementimi dhe funksionimi i sistemeve ndërkombëtare të menaxhimit të cilësisë (ISO 9001), mjedisit (ISO 14001) dhe sigurisë së informacionit (ISO 27001), si bazë për përmirësimin e vazhdueshëm institucional.
- Përvojë në koordinimin dhe zbatimin e projekteve ndërkombëtare (Erasmus+, RECONOMY (Helvetas) dhe iniciativa të tjera), duke forcuar kapacitetet institucionale dhe ndërkombëtarizimin.
- Përvojë në ofrimin e programeve të edukimit të vazhdueshëm, certifikimeve profesionale dhe trajnimeve për sektorin publik dhe privat.
- Profil i qartë institucional dhe identitet unik në fushën e transportit, sigurisë rrugore, logjistikës dhe sigurimeve.

Dobësitë dhe sfidat

- Nevoja për fuqizimin e mëtejshëm të mekanizmave sistematikë për monitorimin e trendeve të tregut të punës dhe integrimin e rezultateve në zhvillimin dhe rishikimin e programeve studimore.
- Nevoja për konsolidimin dhe shfrytëzimin optimal të kampusit të Kolegjit dhe avancimin e vazhdueshëm të kapaciteteve laboratorike dhe teknologjike.
- Nevoja për rishikimin dhe harmonizimin e vazhdueshëm të rregulloreve dhe politikave institucionale me legjislacionin në fuqi dhe standardet kombëtare dhe evropiane të arsimit të lartë.
- Nevoja për fuqizimin e kompetencave në gjuhë të huaja të stafit akademik dhe administrativ, në funksion të ndërkombëtarizimit dhe pjesëmarrjes në projekte dhe mobilitete ndërkombëtare.
- Kapacitete ende të kufizuara për sigurimin e financimit të qëndrueshëm dhe të dedikuar për kërkimin shkencor dhe të aplikuar.
- Pjesëmarrje ende e kufizuar në projekte të mëdha kërkimore dhe programe konkurruese të financimit kombëtar dhe ndërkombëtar.
- Nevoja për rritjen e mobilitetit ndërkombëtar të studentëve dhe stafit.
- Nevoja për fuqizimin e kapaciteteve të stafit dhe studentëve për kërkim shkencor dhe të aplikuar, inovacion dhe transferim të dijes.
- Nevoja për avancimin e mëtejshëm të transformimit digjital dhe integrimin e teknologjive të reja dhe inteligjencës artificiale në proceset akademike dhe administrative..

Mundësitë

- Qasja në programet dhe fondet kombëtare dhe ndërkombëtare për arsimin e lartë, kërkimin shkencor, kërkimin e aplikuar, inovacionin dhe zhvillimin institucional.
- Zgjerimi i pjesëmarrjes në programet Erasmus+ dhe iniciativa të tjera evropiane për mobilitet, bashkëpunim akademik dhe zhvillim institucional.
- Zgjerimi i partneriteteve strategjike me institucione akademike, sektorin publik, industrinë, bizneset dhe organizatat profesionale në nivel vendor dhe ndërkombëtar.
- Zhvillimi dhe ndërkombëtarizimi i programeve studimore dhe krijimi i mundësive për programe të përbashkëta dhe forma të tjera të bashkëpunimit akademik ndërkombëtar.
- Rritja e kërkesës për kërkim të aplikuar, ekspertiza profesionale dhe zgjidhje inovative për nevojat e industrisë, institucioneve dhe komunitetit.
- Fuqizimi i rolit të Institutit për Siguri Rrugore dhe Hulumtime në Transport në realizimin e kërkimeve të aplikuara, projekteve dhe ekspertizave profesionale.
- Fuqizimi i rolit të Qendrës për Hulumtim dhe Zhvillim Profesional në ofrimin e programeve të mësimit gjatë gjithë jetës, edukimit të vazhdueshëm dhe zhvillimit profesional.

- Zhvillimi i programeve të reja studimore dhe profesionale në përputhje me zhvillimet teknologjike dhe nevojat e tregut të punës.
- Përdorimi i inteligjencës artificiale dhe teknologjive digjitale për avancimin e mësimdhënies, kërkimit dhe proceseve institucionale.
- Integrimi i zhvillimit të qëndrueshëm, politikave të gjelbra (Green Policies) dhe parimeve ESG në zhvillimin dhe funksionimin institucional.
- Rritja e rolit të Kolegjit në komunitet përmes aktiviteteve edukative, profesionale, ndërgjegjësuese dhe iniciativave me interes publik.

Rreziqet

- Ndryshimet e shpeshta në legjislacionin, politikat, kriteret dhe standardet që rregullojnë arsimin e lartë dhe proceset e akreditimit.
- Trendet demografike, emigrimi i të rinjve dhe zvogëlimi potencial i numrit të studentëve në arsimin e lartë.
- Largimi i kuadrove të kualifikuara dhe konkurrenca për tërheqjen dhe mbajtjen e stafit akademik dhe profesional.
- Rritja e konkurrencës ndërmjet institucioneve të arsimit të lartë në nivel vendor dhe rajonal.
- Ndryshimet e shpejta teknologjike dhe nevoja për investime të vazhdueshme në teknologji, laboratorë, infrastrukturë digjitale dhe zhvillimin e kompetencave të stafit.
- Kufizimet në sigurimin e burimeve të qëndrueshme financiare dhe varësia nga burime të kufizuara të financimit.
- Konkurrenca e lartë për sigurimin e fondeve dhe pjesëmarrjen në projekte kombëtare dhe ndërkombëtare.
- Ndryshimet e shpejta në mënyrën e të nxënit dhe përdorimi joetik i inteligjencës artificiale në arsimin e lartë.
- Ndryshimet e shpejta në kërkesat e tregut të punës, të cilat kërkojnë përshtatje të vazhdueshme të programeve studimore dhe kompetencave profesionale.
- Rreziqet që lidhen me transformimin digjital, sigurinë kibernetike, mbrojtjen e të dhënave dhe përdorimin e përgjegjshëm të inteligjencës artificiale.
- Pasiguria ekonomike dhe inflacioni, të cilat mund të ndikojnë në aftësinë e studentëve për të financuar studimet.
- Rritja e konkurrencës nga universitetet ndërkombëtare dhe platformat globale të arsimit online.

Vizioni i Kolegjit Tempulli

Institucion unik i arsimit të lartë në vend dhe rajon, me fokus në zhvillimin e shkathtësive kërkimore profesionale përmes ndërlidhjes së mësimdhënies inovative, mësimit praktik dhe punës shkencore për të mirën e komunitetit.

Misioni

Përgatitja në mënyrë cilësore studentët dhe kursantët me njohuritë dhe aftësitë adekuate për të mësuar dhe hulumtuar në mënyrë që të udhëheqin një karrierë të suksesshme profesionale dhe, së bashku me akademinë si dhe individualisht, të kontribuojnë me përgjegjësi për komunitetin.

Kolegji Tempulli kontribuon në shoqëri përmes:

- programeve unike të studimit në arsimin e lartë dhe shkencat e aplikuara, të orientuara drejt nevojave të tregut të punës në Kosovë;
- avancimit, krijimit dhe shpërndarjes së njohurive përmes kërkimit shkencor, me qëllim të përmirësimit të mirëqenies së popullatës;
- sigurimit të një mjedisi që mbështet lëvizshmërinë sociale dhe zhvillimin personal;
- rolit të tij si partner vendor për bizneset, industrinë, institucionet lokale dhe qendrore dhe komunitetin;
- zbatimit të dimensionit shoqëror të Procesit të Bolonjës dhe qasjes së bazuar në të drejtat e njeriut.

Kolegji Tempulli angazhohet vazhdimisht në dialog dhe bashkëpunim me partnerët ekonomikë dhe shoqërorë, me qëllim të ofrimit të shërbimeve relevante arsimore, profesionale dhe kërkimore. Ky bashkëpunim synon të sigurojë përputhjen e programeve studimore dhe kompetencave të studentëve me zhvillimet dhe kërkesat e tregut të punës.

Vizioni dhe misioni promovohen në të gjithë komunitetin akademik dhe shërbejnë si bazë për hartimin, rishikimin dhe miratimin e politikave, rregulloreve dhe dokumenteve institucionale. Përfshirja e stafit, studentëve dhe palëve të tjera të interesit në këto procese synon jo vetëm njohjen e vizionit dhe misionit, por edhe ndërgjegjësimin për rolin dhe përgjegjësinë e secilit në realizimin e tyre.

Në funksion të transparencës dhe komunikimit institucional, Kolegji siguron që Plani Strategjik, drejtimet e zhvillimit dhe rezultatet e zbatimit të tij t'u komunikohen në mënyrë të përshtatshme stafit, studentëve, partnerëve, komunitetit dhe palëve të tjera të interesit.

Vlerat dhe parimet

Vlerat dhe parimet që janë pjesë e rrugës sonë gjatë përballimit të sfidave aktuale:

- **Vlerat**: Kolegji ka një qasje ndaj të tjerëve e cila reflektohet në mënyrën se si ata vlerësojnë kontributin e tyre. Akademia tregon respekt në të gjitha marrëdhëniet e saj me palët e interesit, përfshirë marrëdhëniet midis stafit menaxhues dhe mënyrës se si ajo komunikon me partnerët, financuesit dhe ofron shërbime për qytetarët.
- **Integriteti:** Kolegji do të fitojë besim dhe respekt duke qenë profesionale, etike, e ndershme dhe e paanshme. Ndershmëria dhe sinqeriteti në të gjitha marrëdhëniet dhe komunikimet e Kolegjit siguron që informacioni të jetë në kohë dhe i vërtetë.
- **Përfshirja:** Kolegji është e përkushtuar ndaj diversitetit, barazisë së mundësive dhe drejtësisë sociale për të gjithë, duke vlerësuar dallimet dhe duke i mirëpritur ato.
- **Bashkëpunimi dhe partneriteti:** K vlerëson partneritetin dhe bashkëpunimin si mënyra më efektive për të përmirësuar cilësinë e shërbimeve të saj, duke qenë e hapur për bashkëpunim akademik dhe shkencor, me institucione publike dhe private, lokale dhe ndërkombëtare, në fusha dhe projekte me interes të përbashkët, gjithmonë duke garantuar shprehjen e lirë të ideve dhe duke siguruar stafin dhe studentët me mundësi të barabarta për punë dhe studim.
- **Inovacioni**: Kolegji është e hapur për ndryshim, adaptim, veprim pro-aktiv dhe inovacion në punën e saj të përbashkët për të gjetur metoda të reja për të përmbushur sfidat në një mjedis gjithnjë në ndryshim.
- **Përsosmëria:** Kolegji ka pritje të mëdha për veten e saj, studentët tanë dhe komunitetet tona, prandaj synon të përmirësojë vazhdimisht cilësinë e shërbimeve të saj bazuar në parimin e Akademizmit, transparencës dhe pavarësisë.

OBJEKTIVAT STRATEGJIKE

Plani Strategjik 2026–2030 ndërtohet mbi rezultatet, përvojën dhe mësimet e nxjerra nga zbatimi i Planit Strategjik 2021–2025. Gjatë kësaj periudhe, Kolegji Tempulli konsolidoi strukturat e tij organizative, avancoi sistemin e sigurimit të cilësisë, zhvilloi programet studimore, forcoi bashkëpunimin me partnerët vendorë dhe ndërkombëtarë, investoi në infrastrukturë dhe transformimin digjital, si dhe krijoi baza më të qëndrueshme për kërkimin shkencor dhe të aplikuar, ndërkombëtarizimin dhe shërbimet ndaj studentëve. Ndërkohë, transformimet në arsimin e lartë, ndryshimet në mjedisin ekonomik dhe teknologjik, kërkesat e tregut të punës, proceset e ndërkombëtarizimit, si dhe evoluimi institucional i Kolegjit Tempulli, kanë krijuar nevojën për rishikimin dhe avancimin e objektivave strategjike. Objektivat strategjike të Planit 2026–2030 nuk paraqesin një shkëputje nga strategjia paraprake, por përfaqësojnë vazhdimësinë dhe evolucionin e saj. Ato ruajnë drejtimet themelore të zhvillimit institucional, duke reflektuar njëkohësisht prioritetet e reja të Kolegjit Tempulli në fushën e qeverisjes institucionale, cilësisë akademike, mësimdhënies së orientuar në praktikë, kërkimit shkencor dhe të aplikuar, ndërkombëtarizimit, transformimit digjital, zhvillimit të qëndrueshëm, zhvillimit të karrierës së studentëve dhe angazhimit shoqëror. Në përputhje me vizionin, misionin dhe vlerat institucionale, objektivat strategjike janë ristrukturuar për të siguruar një qasje më të integruar, më të orientuar drejt rezultateve dhe më të harmonizuar me standardet kombëtare dhe evropiane të arsimit të lartë, standardet e akreditimit institucional dhe programor, prioritetet e Hapësirës Evropiane të Arsimit të Lartë (EHEA), si dhe me nevojat e tregut të punës dhe zhvillimit të shoqërisë.

OS1. Qeverisja institucionale, transformimi digjital dhe zhvillimi i qëndrueshëm

Të forcohet qeverisja institucionale, transformimi digjital dhe qëndrueshmëria organizative e financiare për të mbështetur zhvillimin afatgjatë të Kolegjit Tempulli.

Prioritetet strategjike

1.1. Forcimi i qeverisjes institucionale, planifikimit strategjik dhe vendimmarrjes së bazuar në evidencë.

1.2. Avancimi i transformimit digjital dhe modernizimi i proceseve akademike dhe administrative.

1.3. Fuqizimi i kapaciteteve të burimeve njerëzore, avancimi profesional i stafit dhe konsolidimi i kulturës organizative.

1.4. Sigurimi i qëndrueshmërisë financiare dhe diversifikimi i burimeve të financimit.

1.5. Fuqizimi dhe menaxhimi i qëndrueshëm i infrastrukturës fizike dhe teknologjike, përmes avancimit të kapaciteteve infrastrukturore dhe laboratorike.

Në vijim paraqiten treguesit e performancës dhe caqet vjetore për secilin prioritet strategjik të Objektivit Strategjik 1 (OS1), të cilët do të shërbejnë për monitorimin dhe vlerësimin e progresit të zbatimit të Planit Strategjik gjatë periudhës 2026–2030.

1.1. Forcimi i qeverisjes institucionale, planifikimit strategjik dhe vendimmarrjes së bazuar në evidencë					
Treguesit	**2026**	**2027**	**2028**	**2029**	**2030**
Numri i raporteve të monitorimit dhe vlerësimit të planit strategjik	2	2	2	2	2
Numri i politikave/rregulloreve institucionale të rishikuara ose miratuara	2	2	3	3	3
Kënaqësia e palëve të brendshme me transparencën dhe qeverisjen	75%	78%	80%	83%	85%

1.2. Avancimi i transformimit digjital dhe modernizimi i proceseve akademike dhe administrative					
Treguesit	**2026**	**2027**	**2028**	**2029**	**2030**
Përqindja e proceseve prioritare akademike dhe administrative të digjitalizuara	55%	65%	75%	85%	95%
Numri i proceseve/shërbimeve të reja të digjitalizuara gjatë vitit	2	3	5	7	10
Përqindja e stafit të trajnuar për përdorimin e sistemeve digjitale dhe AI	40%	55%	70%	85%	95%
Disponueshmëria funksionale e sistemeve kryesore digjitale	95%	95%	95%	95%	99%

1.3. Fuqizimi i kapaciteteve të burimeve njerëzore, avancimi profesional i stafit dhe konsolidimi i kulturës organizative					
Treguesit	**2026**	**2027**	**2028**	**2029**	**2030**
Përqindja e stafit që merr pjesë së paku në një aktivitet zhvillimi profesional gjatë vitit	70%	75%	80%	85%	90%
Numri i aktiviteteve të zhvillimit profesional për stafin akademik dhe administrativ	2	2	3	3	3
Përqindja e stafit të vlerësuar sipas procedurave të performancës	80%	90%	100%	100%	100%
Kënaqështmëria e stafit me mjedisin dhe kulturën organizative	75%	78%	80%	83%	85%

1.4. Sigurimi i qëndrueshmërisë financiare dhe diversifikimi i burimeve të financimit					
Treguesit	**2026**	**2027**	**2028**	**2029**	**2030**
Përqindja e realizimit të të hyrave vjetore në raport me planifikimin buxhetor	≥90%	≥92%	≥94%	≥95%	≥95%
Përqindja e të hyrave nga burime të tjera përveç tarifave të studimit ndaj të hyrave totale	≥50%	≥50%	≥45%	≥35%	≥30%
Numri i projekteve/kontratave të financuara nga burime të jashtme	≥1	≥1	≥2	≥3	≥4

1.5. Fuqizimi dhe menaxhimi i qëndrueshëm i infrastrukturës fizike dhe teknologjike, përmes avancimit të kapaciteteve infrastrukturore dhe laboratorike.					
Treguesit	**2026**	**2027**	**2028**	**2029**	**2030**
Përqindja e realizimit të investimeve të planifikuara në infrastrukturën fizike dhe teknologjike	≥70%	≥70%	≥70%	≥70%	≥70%
Numri i pajisjeve të reja për laboratorë ose modernizimi i tyre	≥1	≥1	≥1	≥1	≥1
Përqindja e masave prioritare Green/ESG të zbatuara në kampus përfshirë reduktimin e përdorimit të letrës, riciklimin dhe përdorimin racional të burimeve.	20%	40%	60%	80%	100%
Kënaqshmëria e studentëve dhe stafit me infrastrukturën dhe shërbimet teknologjike	75%	78%	82%	85%	90%

OS2. Cilësia akademike, mësimdhënia e orientuar në praktikë dhe sigurimi i cilësisë

Të avancohen cilësia akademike dhe programet studimore, të fuqizohet mësimdhënia dhe të nxënit e orientuar në praktikë, si dhe të forcohet sistemi i sigurimit të cilësisë në përputhje me standardet kombëtare dhe evropiane të arsimit të lartë dhe nevojat e tregut të punës.

Prioritetet strategjike

2.1. Zhvillimi, rishikimi. diversifikimi dhe ndërkombëtarizimi i programeve studimore në përputhje me zhvillimet akademike, profesionale dhe ndërkombëtare.

2.2. Avancimi i cilësisë së mësimdhënies, të nxënit dhe vlerësimit, me fokus në mësimdhënien e orientuar në praktikë dhe zhvillimin e kompetencave profesionale të studentëve.

2.3. Forcimi i sistemit të sigurimit të cilësisë dhe kulturës institucionale të cilësisë.

2.4. Integrimi i teknologjive digjitale, inteligjencës artificiale dhe metodave inovative në procesin e mësimdhënies dhe të nxënit.

2.5. Harmonizimi i programeve studimore me standardet evropiane, zhvillimet ndërkombëtare dhe nevojat e tregut të punës.

Në vijim paraqiten treguesit e performancës dhe caqet vjetore për secilin prioritet strategjik të Objektivit Strategjik 2 (OS2), të cilët do të shërbejnë për monitorimin dhe vlerësimin e progresit të zbatimit të Planit Strategjik gjatë periudhës 2026–2030.

2.1. Zhvillimi, rishikimi. diversifikimi dhe ndërkombëtarizimi i programeve studimore në përputhje me zhvillimet akademike, profesionale dhe ndërkombëtare					
Treguesit	**2026**	**2027**	**2028**	**2029**	**2030**
Përqindja e programeve të rishikuara sipas planit	40%	60%	80%	90%	100%
Numri i programeve të reja ose të diversifikuara	1	2	3	3	≥3
Numri i programeve me elemente të ndërkombëtarizimit	1	2	3	3	≥3
Përqindja e rekomandimeve relevante të industrisë dhe punëdhënësve të reflektuara në zhvillimin dhe rishikimin e programeve studimore.	≥70%	≥75%	≥80%	≥85%	≥90%

2.2. Avancimi i cilësisë së mësimdhënies, të nxënit dhe vlerësimit, me fokus në mësimdhënien e orientuar në praktikë dhe zhvillimin e kompetencave profesionale të studentëve					
Treguesit	**2026**	**2027**	**2028**	**2029**	**2030**
Përqindja e lëndëve me metoda aktive dhe mësimdhënie praktike	70%	80%	85%	90%	100%
Numri i trajnimeve pedagogjike për stafin	1	2	3	4	≥4
Përqindja e stafit që merr pjesë në zhvillim profesional	70%	80%	85%	90%	≥95%
Niveli i kënashqmërisë së studentëve me procesin mësimor	80%	82%	85%	88%	≥90%

2.3. Forcimi i sistemit të sigurimit të cilësisë dhe kulturës institucionale të cilësisë					
Treguesit	**2026**	**2027**	**2028**	**2029**	**2030**
Përqindja e rekomandimeve të zbatuara nga proceset e cilësisë	75%	80%	85%	90%	≥95%
Numri i raporteve të vetëvlerësimit	2	2	2	2	2
Përqindja e përfshirjes së palëve të interesit në proceset e cilësisë	75%	80%	85%	90%	≥95%
Numri i proceseve të rishikimit të politikave/rregulloreve/mjeteve	1	2	2	2	≥5

2.4. Integrimi i teknologjive digjitale, inteligjencës artificiale dhe metodave inovative në procesin e mësimdhënies dhe të nxënit					
Treguesit	**2026**	**2027**	**2028**	**2029**	**2030**
Përqindja e lëndëve që përdorin platforma digjitale	40%	60%	85%	90%	100%
Përqindja e lëndëve që integrojnë AI ose mjete inovative	20%	35%	50%	70%	90%
Numri i trajnimeve për AI dhe teknologji digjitale	1	2	2	2	≥5

2.5. Harmonizimi i programeve studimore me standardet evropiane, zhvillimet ndërkombëtare dhe nevojat e tregut të punës					
Treguesit	**2026**	**2027**	**2028**	**2029**	**2030**
Përqindja e programeve të harmonizuara me standardet evropiane	75%	85%	90%	95%	100%
Numri i konsultimeve me punëdhënës, Alumni dhe partnerë	1	2	3	3	≥4
Numri i rishikimeve të kurrikulave bazuar në analizat e tregut	1	1	2	2	≥4

OS3. Kërkimi shkencor dhe i aplikuar, inovacioni dhe transferimi i dijes

Të fuqizohet dhe zhvillohet më tej kërkimi shkencor dhe i aplikuar, të promovohet inovacioni dhe transferimi i dijes, duke kontribuar në zhvillimin ekonomik, profesional dhe shoqëror përmes projekteve, ekspertizave dhe partneriteteve strategjike.

Prioritetet Strategjike

3.1. Avancimi i cilësisë dhe produktivitetit të kërkimit shkencor.

3.2. Fuqizimi dhe zhvillimi i mëtejshëm i kërkimit të aplikuar dhe rolit të Institutit për Siguri Rrugore dhe Hulumtime në Transport, përmes bashkëpunimit me industrinë, institucionet dhe komunitetin.

3.3. Rritja e pjesëmarrjes në projekte kërkimore dhe inovative kombëtare dhe ndërkombëtare.

3.4. Promovimi i inovacionit dhe transferimit të dijes.

3.5. Fuqizimi dhe zhvillimi i mëtejshëm i kapaciteteve të stafit akademik dhe studentëve për kërkim shkencor dhe të aplikuar, inovacion dhe transferim të dijes.

Në vijim paraqiten treguesit e performancës dhe caqet vjetore për secilin prioritet strategjik të Objektivit Strategjik 3 (OS3), të cilët do të shërbejnë për monitorimin dhe vlerësimin e progresit të zbatimit të Planit Strategjik gjatë periudhës 2026–2030.

3.1. Avancimi i cilësisë dhe produktivitetit të kërkimit shkencor					
Treguesit	**2026**	**2027**	**2028**	**2029**	**2030**
Numri i publikimeve shkencore në revista dhe konferenca të indeksuara ose të recenzuara	2	4	6	8	≥10
Përqindja e stafit akademik me së paku një rezultat kërkimor gjatë vitit	45%	55%	65%	75%	≥80%
Numri i punimeve shkencore të realizuara me bashkautorësi ndërinstitucionale ose ndërkombëtare	2	3	4	5	≥6
Përqindja e publikimeve që lidhen me fushat prioritare të Kolegjit	60%	70%	75%	80%	≥85%

3.2. Fuqizimi dhe zhvillimi i mëtejshëm i kërkimit të aplikuar dhe rolit të Institutit për Siguri Rrugore dhe Hulumtime në Transport, përmes bashkëpunimit me industrinë, institucionet dhe komunitetin					
Treguesit	**2026**	**2027**	**2028**	**2029**	**2030**
Numri i projekteve ose studimeve të kërkimit të aplikuar të realizuara për industri, institucione ose komunitet	2	3	4	5	≥6
Numri i ekspertizave, analizave ose shërbimeve profesionale të realizuara përmes Institutit	4	5	6	7	≥8
Numri i rekomandimeve ose zgjidhjeve të aplikuara në praktikë nga projektet e Institutit	1	2	3	4	≥5

3.3. Ritja e pjesëmarrjes në projekte kërkimore dhe inovative kombëtare dhe ndërkombëtare					
Treguesit	**2026**	**2027**	**2028**	**2029**	**2030**
Numri i aplikimeve në thirrje kombëtare dhe ndërkombëtare për projekte	2	3	4	5	≥6
Numri i projekteve kërkimore ose inovative të financuara	1	1	2	2	≥3
Numri i projekteve me partnerë ndërkombëtarë	1	1	2	2	≥3

3.4. Promovimi i inovacionit dhe transferimit të dijes					
Treguesit	**2026**	**2027**	**2028**	**2029**	**2030**
Numri i iniciativave, ideve ose projekteve inovative të zhvilluara nga stafi dhe studentët	1	2	3	4	≥5
Numri i aktiviteteve për inovacion dhe transferim të dijes	1	2	3	4	≥5
Numri i zgjidhjeve, produkteve, prototipeve ose metodologjive të transferuara te partnerët/komuniteti	1	2	3	4	≥5

3.5. Fuqizimi dhe zhvillimi i mëtejshëm i kapaciteteve të stafit akademik dhe studentëve për kërkim shkencor dhe të aplikuar, inovacion dhe transferim të dijes					
Treguesit	**2026**	**2027**	**2028**	**2029**	**2030**
Numri i trajnimeve, punëtorive ose mentorimeve për kërkim dhe inovacion	1	3	4	5	≥5
Numri i studentëve të përfshirë në projekte kërkimore, të aplikuara ose inovative	3	5	10	15	≥20
Numri i punimeve ose projekteve të përbashkëta staf–studentë	2	3	4	5	≥6
Përqindja e stafit akademik të përfshirë në zhvillimin e kapaciteteve akademike, profesionale dhe kërkimore në përputhje me profilin dhe nevojat zhvillimore të programeve të studimit	50%	60%	70%	80%	≥90%

OS4. Ndërkombëtarizimi, partneritetet strategjike dhe bashkëpunimi institucional

Të fuqizohet prania dhe bashkëpunimi institucional i Kolegjit Tempulli në nivel vendor dhe ndërkombëtar përmes partneriteteve strategjike me sektorin akademik, publik, privat dhe profesional, mobilitetit akademik, projekteve dhe rrjeteve të bashkëpunimit.

Prioritetet strategjike

4.1. Zgjerimi dhe fuqizimi i partneriteteve strategjike me sektorin akademik, publik, privat dhe profesional në nivel vendor dhe ndërkombëtar.

4.2. Rritja e mobilitetit ndërkombëtar të studentëve dhe stafit akademik dhe administrativ.

4.3. Fuqizimi i ndërkombëtarizimit të aktiviteteve akademike dhe institucionale.

4.4. Rritja e dukshmërisë dhe fuqizimi i reputacionit kombëtar dhe ndërkombëtar të Kolegjit Tempulli.

Në vijim paraqiten treguesit e performancës dhe caqet vjetore për secilin prioritet strategjik të Objektivit Strategjik 4 (OS4), të cilët do të shërbejnë për monitorimin dhe vlerësimin e progresit të zbatimit të Planit Strategjik gjatë periudhës 2026–2030.

4.1. Zgjerimi dhe fuqizimi i partneriteteve strategjike me sektorin akademik, publik, privat dhe profesional në nivel vendor dhe ndërkombëtar					
Treguesit	**2026**	**2027**	**2028**	**2029**	**2030**
Numri i marrëveshjeve të reja të bashkëpunimit	2	5	7	9	≥10
Përqindja e marrëveshjeve aktive të bashkëpunimit me aktivitete konkrete të realizuara	40%	50%	60%	70%	≥80%
Numri i aktiviteteve të përbashkëta me partnerët	2	5	7	9	≥12

4.2. Rritja e mobilitetit ndërkombëtar të studentëve dhe stafit akademik dhe administrativ					
Treguesit	**2026**	**2027**	**2028**	**2029**	**2030**
Numri i studentëve në mobilitet ndërkombëtar	1	3	5	9	≥12
Numri i stafit akademik dhe administrativ në mobilitet	2	4	5	7	≥10
Numri i marrëveshjeve Erasmus+/mobilitet	1	2	3	4	≥5
Përqindja e pjesëmarrësve të kënaqur me mobilitetin	80%	85%	90%	90%	≥95%

4.3. Fuqizimi i ndërkombëtarizimit të aktiviteteve akademike dhe institucionale					
Treguesit	**2026**	**2027**	**2028**	**2029**	**2030**
Numri i aktiviteteve akademike me pjesëmarrje ndërkombëtare	1	3	5	8	≥10
Numri i shkollave verore/dimerore te organizuara	1	2	3	4	4
Numri i ligjëruesve/profesorëve vizitorë	1	2	3	4	≥5

Numri i iniciativave për zhvillimin e programeve të përbashkëta dhe formave të avancuara të bashkëpunimit akademik ndërkombëtar.	0	≥1	≥1	≥2	≥2

4.4. Rritja e dukshmërisë dhe fuqizimi i reputacionit kombëtar dhe ndërkombëtar të Kolegjit Tempulli					
Treguesit	**2026**	**2027**	**2028**	**2029**	**2030**
Numri i aktiviteteve promovuese kombëtare dhe ndërkombëtare	3	5	8	10	≥12
Përqindja e rritjes së prezencës digjitale	10%	20%	30%	40%	≥50%
Numri i publikimeve/lajmeve në media dhe platforma online	10	15	20	25	≥30

OS5. Studentët, zhvillimi i karrierës dhe angazhimi shoqëror

Të ofrohet një përvojë gjithëpërfshirëse studentore, të fuqizohet zhvillimi i karrierës, shkathtësive dhe kompetencave profesionale në përputhje me nevojat e tregut të punës, të promovohet mësimi gjatë gjithë jetës dhe të forcohet angazhimi dhe kontributi i Kolegjit Tempulli në zhvillimin ekonomik, profesional dhe shoqëror të komunitetit.

Prioritetet Strategjike

5.1. Avancimi i përvojës, mirëqenies dhe mbështetjes gjithëpërfshirëse të studentëve.

5.2. Fuqizimi i zhvillimit të karrierës, shkathtësive dhe kompetencave profesionale të studentëve dhe të diplomuarve në përputhje me nevojat e tregut të punës.

5.3. Fuqizimi i rolit të Qendrës për Hulumtim dhe Zhvillim Profesional në ofrimin e programeve të mësimit gjatë gjithë jetës, edukimit të vazhdueshëm dhe zhvillimit profesional

5.4. Forcimi i bashkëpunimit me Alumni, punëdhënësit dhe partnerët institucionalë në mbështetje të zhvillimit profesional dhe të karrierës së studentëve dhe të diplomuarve.

5.5. Rritja e angazhimit shoqëror dhe përgjegjësisë sociale të Kolegjit Tempulli përmes aktiviteteve me interes publik, programeve edukative, iniciativave ndërgjegjësuese dhe kontributit në zhvillimin e qëndrueshëm dhe mirëqenien e komunitetit.

Në vijim paraqiten treguesit e performancës dhe caqet vjetore për secilin prioritet strategjik të Objektivit Strategjik 5 (OS5), të cilët do të shërbejnë për monitorimin dhe vlerësimin e progresit të zbatimit të Planit Strategjik gjatë periudhës 2026–2030.

